

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIIN)

Kujtimi / *et-Tedhekkur* / التَّدَكُّرُ

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ thotë:

“Dhe nuk kujton kush pos atij që kthehet (i penduar).” (Ghaafir, 13)

Kujtimi (*tedhekkur*) është një shkallë më e lartë se reflektimi (*tefekkur*).

Reflektimi është ndjekje e diçkaje, kujtimi nënkupton gjetjen e saj.¹ Kujtimi qëndron në tri shtylla:

- Dobia nga nxitja për të mirë
- Njohja e thellë e mësimave²
- Vjelja e fryteve të reflektimit³

Dobia nga nxitja për të mirë varet nga tri gjëra:

¹ *Tedhekkur* (kujtimi) – që s’është vetëm shqiptimi i Kuranit – është sjellja e fryteve të reflektimit (*tefekkur*) në qendër të vëmendjes dhe marrja e tyre me seriozitet. Nëpërmjet shqiptimit të emrave të Allahut, arrihet edhe një nivel tjetër meta-racional i njohjes (përtej racionales, jo në kundërshtim me racionalen). Kujtimi dhe reflektimi duhet të bashkëjetojnë vazhdimisht dhe të ndërveprojnë në ndreqjen e vetvetes. Hasan el-Basri tha: “Njerëzit e dijes, duke iu përgjëruar zemrave që të flasin, kanë vazhduar ta zgjerojnë mendimin me kujtim (*tedhekkur*) dhe kujtimin me mendim, derisa zemrat folën (me urtësi).” Ndonëse reflektimi dhe kujtimi përmenden si shkallë (stacione) në vete, ato gjithashtu janë pajisje në udhëtimin e njohjes dhe të devotshmërisë. Me fjalë të tjera, ato janë konstantat e dijes së udhëtimit.

² Çdo ditë, Allahu na jep një mësim të ri nëpërmjet ngjarjeve të mira e të këqija. Reflektimi për këto ngjarje mundëson shpimin (penetrimin) intelektual të cipës së jashtme të realiteteve dhe të kuptuarit e realiteteve apo të vërtetave të brendshme. Kujtimi (*tedhekkur*) do të ta mundësojë t’i asimilosh gjetjet dhe t’i përdorësh, duke krijuar kështu një bazë elementare për shkallët (stacionet) e tjera, si: falënderimi (*shukr*), durimi (*sabri*), mbështetja (*tewekul*), shpresa, frika, pendimi, etj.

³ T’i kthesh në qendrën e vëmendjes dhe të ndërtosh mbi to. Reflektimi (*tefekkur*) këtu nuk do të kufizohet në funksionin e vet njohës, por do të shkojë përtej kësaj për të ndikuar në përjetimet emocionale, psikologjike e shpirtërore të atij që reflekton, duke e riformuar dhe duke ia ndryshuar pikëpamjen dhe sjelljen.

- Nevoja e menjëhershme për të⁴
- Verbëria ndaj gabimeve të nxitësit për të mirë (predikuesit)
- Kujtimi i premtimeve dhe i paralajmërimeve (të Allahut)

Njohja e thellë e mësimave varet nga tri gjëra:

- Gjallëria e intelektit
- Njohja e ditëve⁵
- Shërimi nga dëshirat (prirjet) e papërshtatshme

Vjelja e fryteve të reflektimit varet nga tri gjëra:

- Vogëlsia e shpresës (për jetëgjatësi)
- Reflektimi për Kuranin
- Kufizimi i përzierjes⁶, të bërit e qejfit vetes⁷, lidhja për gjërat⁸, ngopja, dhe gjumi (i tepërt).

⁴ A ke parë sesi uji ka shije të ndryshme për një të etur?

⁵ Kjo ka të bëjë ose me ditët personale, domethënë në shtimet dhe pakësimet në gjendjen personale; ose me ditët e Allahut, pra me qeverisjen e atyre që e kundërshtojnë dhe të atyre që dëgjojnë Atë.

⁶ Të përzihesh me njerëz dhe të harxhohesh në punët e tyre.

⁷ Vonesa në kthimin tek Allahu me pendim dhe vënia në hesap e faljes nga Ai pa e kërkuar (faljen).

⁸ Lidhja për të tjerë veç Allahut.